

**MIRË SE VINI NË ALPEX
NAD INVESTMENT SH.P.K**

Me kënaqësi njoftojmë Anëtarësimin e NAD Investment Sh.p.k në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike- ALPEX sh.a, për zonën ofertuese të Shqipërisë.

Si një tregtar dhe furnizues i licencuar i energjisë elektrike, NAD Investment operon në tregun me shumicë të energjisë elektrike me fokus të fortë tek besueshmëria, profesionalizmi dhe përputhshmëria me rregullat e tregut. Pjesëmarrja e saj në ALPEX, si në Tregun e Ditës në Avancë (DAM) ashtu edhe në Tregun Brenda së njëjtës Ditë (IDM), përbën një hap të rëndësishëm drejt thellimit të mëtejshëm të zhvillimit të tregut dhe integritetit rajonal.

Ne i urojmë mirëseardhjen Kompanisë NAD Investment në ALPEX dhe presim me padurim një bashkëpunim të suksesshëm dhe afatgjatë drejt ndërtimit të një tregu të energjisë më konkurrues, të qëndrueshëm dhe të integruar.

Kontakt**Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX sh.a**

Adresa: Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic,
Hyrja 3, Kati 1, Zyra nr.1, Tirana, Albania.
Email: info@alpex.al